



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA**



**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**

**PROJEKT-RREGULLORE
PËR
TAKSA, TARIFA DHE GJOBAT KOMUNALE NË
KOMUNËN E FUSHË-KOSOVËS**

Në mbështetje të nenit 11 dhe nenit 12, paragrafi 2, pika (c), të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008), në mbështetje të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 27/2008), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-108 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2016), dhe konform nenit 13, paragrafi 13.6, pika (c) të Statutit të Komunës në Fushë-Kosovë, 01-Nr-98, me datë 17.08.2012, Kuvendi i Komunës në Fushë-Kosovë, në mbledhjen e mbajtur me datën _____, miraton këtë:

**PROJEKT-RREGULLORE PËR TAKSA, TARIFA DHE GJOBAT KOMUNALE
NË KOMUNËN E FUSHË KOSOVË**

**KAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

Neni 1

Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e aktiviteteve të cilat i nënshtrohen taksës dhe tarifës komunale në Komunën e Fushë-Kosovës, lartësinë e taksave dhe tarifave komunale, përcaktimin e kategorive të liruara nga kjo tarifë dhe përcaktimin e kundërvajtjeve dhe sanksioneve kundërvajtëse për shkeljet e dispozitave të kësaj rregulloreje.

Neni 2

Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj rregulloreje janë të obligueshme për të gjithë personat fizikë dhe juridikë që nëpërmjet ndonjë aktiviteti të zhvilluar obligohen të paguajnë tarifën komunale të përcaktuar me këtë rregullore, si dhe për të gjitha njësitë e Komunës që zbatojnë dispozitat e kësaj rregulloreje.

Neni 3

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këto kuptime:

1.1 Taksë komunale – nënkupton shumën fikse dhe të pakthyeshme të pagesës sipas dispozitave të kësaj rregulloreje, që paguhet nga personat juridikë dhe fizikë autoriteteve të Komunës në mënyrën e paraparë në këtë rregullore, në emër të:

1.1.1 Lëshimit të certifikatave dhe dokumenteve të tjera zyrtare të lëshuara nga Komuna;

1.1.2 Shërbimeve administrative të pranuar nga Komuna;

1.1.3 Ushtrimit të veprimtarisë afariste në territorin e Komunës;

1.1.4 Pronësisë së mjeteve motorike në territorin e Komunës;

1.1.5 Ndërtimit, rrënimit të objekteve dhe ndërhyrjeve specifike komunale në territorin e Komunës;

1.1.6 Shfrytëzimit të objekteve, hapësirës apo të mirave të tjera publike në territorin e Komunës.

1.2 Taksa qendrore – nënkupton taksat që përcaktohen nga Qeveria e Republikës së Kosovës, të cilat mbliidhen nga Komuna

1.3 Vit specifik – nënkupton periudhën nga data një (1) janar deri më datën tridhjetë e një (31) janar të të njëjtit vit

1.4 Gjobë – nënkupton sanksionin kundërvajtës që u shqiptohet personave juridikë dhe fizikë për shkelje të dispozitave të kësaj rregulloreje

1.5 Person – nënkupton personin fizik dhe juridik

1.6 Person fizik – nënkupton personin fizik joafarist që nuk ka të regjistruar aktivitet biznesi; dhe personin fizik afarist që ka të regjistruar biznes në bazë të legjislacionit në fuqi dhe që zhvillon aktivitet të rregullt afarist

1.7 Person juridik – nënkupton një shoqëri ose një organizatë tjetër biznesi që ka statusin e një personi juridik sipas legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare dhe çdo legjislacion tjetër të aplikueshëm në Kosovë

1.8 Pano reklamuese – nënkupton tabelën apo shenjën reklamuese me qëllim të reklamimit të mallrave apo shërbimeve, e vendosur apo lëvizëse

1.9 Shoqëri tregtare – nënkupton termin e përgjithshëm që përfshin çfarëdo lloji të shoqërisë tregtare të themeluar në Kosovë sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare apo ndonjë ligji tjetër, duke përfshirë bizneset individuale, ortakëritë e përgjithshme, ortakëritë e kufizuara, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare

1.10 Organi kundërvajtës – nënkupton drejtorinë përkatëse të inspektimeve, e cila është përgjegjëse për zbatimin e dispozitave ndëshkimore të rregulloreje

KAPITULLI II: KORNIZAT E PËRGJITHSHME TË TAKSAVE KOMUNALE

Neni 4

Parimet e përgjithshme të taksave komunale në Komunë

1. Të gjitha taksat komunale përcaktohen me këtë rregullore dhe me ndonjë rregullore tjetër komunale.
2. Të gjitha taksat komunale përcaktohen duke marrë parasysh parimin e jodiskriminimit dhe të proporcionalitetit, sipas dispozitave ligjore në fuqi.
3. Taksat komunale që rezultojnë si pasojë e ndonjë veprimi apo shërbimi të kryer nga organet e Komunës bazohen në koston e atij veprimi që i është shkaktuar Komunës. Asnjë specifikë komunale që nuk është e përcaktuar me këtë rregullore apo në ndonjë rregullore tjetër komunale nuk mund të kërkohet që të paguhet.

Neni 5

Pagesa e taksave komunale

1. Të gjitha pagesat e taksave komunale që duhet të kryhen sipas dispozitave të kësaj rregulloreje bëhen sipas shumave të përcaktuara në këtë rregullore dhe paguhen në valutën euro (€)
2. Të gjitha pagesat mbi dhjetë (10) € sipas kësaj rregulloreje bëhen nëpërmjet bankave apo institucioneve financiare të licencuara, nëpërmjet një urdhërpagese të pranuar nga zyrtari përkatës komunal, në xhirollogarinë e Komunës të përcaktuar me vendimin e Kryetarit të Komunës
3. Të gjitha pagesat deri në dhjetë (10) € sipas kësaj rregulloreje bëhen pranë institucioneve përkatëse komunale
4. Për pagesat e realizuara sipas paragrafit tre (3) të këtij neni, Komuna lëshon vërtetim përkatës, të gjitha pagesat e realizuara sipas paragrafit tre (3) të këtij neni dhe pagesat e bëra nëpërmjet kioskave elektronike (e-kiosku), deponohen në xhirollogarinë e Komunës deri në fund të ditës së pranimit.

Neni 6

Lirimet nga taksat komunale

1. Të gjitha kategoritë e liruara nga pagesa e taksave komunale sipas dispozitave të kësaj rregulloreje përcaktohen me këtë rregullore
2. Për çdo lloj lirimi nga taksat komunale të përcaktuara me këtë rregullore, personat që përfitojnë nga ky lirim ofrojnë dokumentacionon përkatës që dëshmon përkatësinë e tyre për të përfituar nga lirimet
3. Qytetarët të cilët u përkasin kategorive si në vijim: Shfrytëzuesit e ndihmës sociale; familjet e dëshmorëve dhe të zhdukurve të UÇK-së; invalidët e luftës së UÇK-së dhe anëtarët e familjes së ngushtë; veteranët e luftës së UÇK-së dhe anëtarët e familjes së ngushtë; personat me aftësi të

kufizuara; familjet strehuese të fëmijëve pa kujdes prindëror; personat me nevoja të veçanta; nënat vetëushqyese, lirohen nga pagesa e certifikatës, dokumenteve zyrtare dhe taksave komunale administrative

4. Për çdo lloj lirimi nga taksat komunale të përcaktuara me këtë rregullore, zyrtari përgjegjës i Komunës ia bashkëngjijt lëndës shkresën me bazën ligjore për lirim nga pagesa
5. Nëse ndonjë procedurë ku kërkohet pagesa e taksave komunale është filluar me kërkesë të më shumë se një personi, ku jo të gjithë janë të liruar nga pagesa e taksave komunale, atëherë taksa komunale paguhet nga ai person i cili nuk është i liruar nga pagesa, te zyrtari i autorizuar i cili obligohet t'i japë dëshmi mbi pagesën e bërë
6. Të gjitha bizneset që ushtrojnë aktivitete ekonomike ngarkohen me taksa në aktivitet të veprimtarisë primare të aktivitetit ekonomik (100% nga tarifa bazë)
7. Të gjitha subjektet afariste që veprojnë në Komunën e Fushë-Kosovës, ndërsa selinë e kanë jashtë Komunës së Fushë-Kosovës, nuk përjashtohen nga taksat dhe ngarkohen me taksën bazë
8. Bizneset afariste që operojnë në shumë lokacione brenda komunës, me firmë dhe aktivitet të njëjtë por me njësi të ndryshme, ngarkohen me 50% për çdo njësi, përveç njësisë kryesore që ngarkohet me taksën bazë
9. Bizneset e reja lirohen nga taksa për ushtrim të veprimtarisë afariste për një vit nga data e regjistrimit. *(Analizohet veprimtaria: 6 muaj - rekomandim për ndryshim)*
10. Bizneset e reja që regjistrohen në emër të grave dhe të rinjve nën moshën 25 vjeçare lirohen nga taksat 50% për 3 vite. *(1 vit - rekomandim për ndryshim)*
11. Bizneset që ushtrojnë aktivitete të pastra të bujqësisë dhe blegtorisë lirohen nga taksa për ushtrim të aktivitetit afarist për 5 vitet e ardhshme duke filluar nga viti 2026. *(1 vit - rekomandim për ndryshim)*
12. Bizneset që merren me veprimtari specifike dhe që janë të obliguara të kenë licenca profesionale janë të detyruara të pajisen me licenca.

KAPITULLI III: SEKTORI I PËRGJITHSHËM

Neni 7

DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

Taksat (tarifat) për lëshimin e vërtetimeve dhe dokumenteve zyrtare

Nr.	EMËRTIMI (Tarifat dhe taksat në shërbime)	Euro
1.1	Për pranimin e kërkesës	1.00 €

1.2	Për fotokopjimin dhe vërtetimin e identitetit nga arkivi	3.00 €
1.3	Kërkesë për vërtetimin e deklaratës që personi është i vetëm	2.00 €
1.4	Kërkesë për vërtetimin e deklaratës mbi raportin e lidhjes familjare	2.00 €
1.5	Kërkesë për vërtetimin e deklaratës mbi vendqëndrimin e përkohshëm	2.00 €
1.6	Kërkesë për huazimin e dokumenteve të lejueshme nga arkivi	5.00 €
1.7	Kërkesë për vërtetimin e deklaratës mbi nacionalitetin e qytetarit (kombësinë)	2.00 €
1.8	Kërkesë për vërtetimin e deklaratave të ngjashme varësisht nga kushtet aktuale	2.00 €
1.9	Njëjtësimi i dokumenteve: Një (1) faqe A4	0.50 €
1.10	Njëjtësimi i dokumenteve: Një (1) faqe A3	1.00 €
1.11	Për vërtetimin që personi është në jetë (gjallë)	3.00 €
1.12	Kërkesë për specifikë	5.00 €
1.13	Për ankesat që paraqiten kundër vendimit të cilin e bien shkallës së parë, paguhet tarifa në shumën prej	5.00 €

Taksat në Sektorin e Gjendjes Civile

Nr.	EMËRTIMI	Euro
1.13	Për ekstrakt të lindjes	1.00 €
1.14	Për certifikatë të martesës	1.00 €
1.15	Për certifikatë të vdekjes	1.00 €

1.16	Për aktvdekje (trashëgimia) - <i>Nuk lirohet askush nga kjo tarifë</i>	5.00 €
1.17	Për certifikatë të statusit martesor	5.00 €
1.18	Për deklaratë të bashkësisë familjare (brenda vendit)	2.00 €
1.19	Për deklaratë të bashkësisë familjare (jashtë vendit)	2.00 €
1.20	Për certifikatë të vendbanimit	1.00 €
1.21	Për certifikatë shtetësie	2.00 €
1.22	Për vërtetim nga arkivi / vërtetime / konfirmime / deklarata të ndryshme	1.00 €
1.23	Për regjistrim të lindjes me vonesë	10.00 €
1.24	Për regjistrim të lindjes speciale (lindja jashtë vendit) - plus i jepet ekstrakti	2.00 €
1.25	Për regjistrim të martesës speciale jashtë vendit - plus i jepet certifikata	2.00 €
1.26	Për lidhje të martesës / ceremonia	10.00 €
1.27	Për lidhje të martesës me shtetas të huaj	20.00 €
1.28	Për lidhje të martesës jashtë orarit të punës së Komunës	100.00 €
1.29	Për lidhje të martesës jashtë orarit të punës dhe jashtë Komunës	200.00 €
1.30	Kërkesa për lirim nga shtetësia	10.00 €
1.31	Për regjistrim të vdekjes me vonesë: Deri në 5 (pesë) vite nga vdekja	5.00 €
	Mbi 5 (pesë) vite nga vdekja	10.00 €
1.32	Për korrigjim të të dhënave në librat amë/regjistra (<i>Nëse ka qenë gabim i Komunës, të jetë falas</i>)	5.00 € 0.00€
1.33	Për regjistrim të vdekjes	0.00 €
1.34	Për ndërrimin e emrit personal: 1.34.1 (deri në moshën 18 vjeçare)	25.00 €
	1.34.2 (mbi moshën 18 vjeçare)	35.00 €

Neni 8

Lartësia dhe pagesa e taksës për lëshimin e certifikatave dhe dokumenteve zyrtare

1. Të gjithë personat që pajisen me certifikata zyrtare dhe dokumente të tjera zyrtare nga Komuna paguajnë tarifa komunale si në tabelat e lartcekura
2. Pagesa sipas paragrafit 1 të këtij neni bëhet para pranimit të certifikatës apo dokumenteve zyrtare. Pa dëshmi të pagesës nuk mund të merret certifikata apo dokumenti zyrtar
3. Pagesa për shërbimet e kryera bëhet në llogarinë rrjedhëse të Komunës së Fushë-Kosovës apo drejtpërdrejt te zyrtari i autorizuar, i cili obligohet që t'i japë dëshmi palës mbi pagesën e bërë
4. Për pagesat e bëra sipas paragrafit 1 të këtij neni, Komuna lëshon dëshminë përkatëse dhe ky vërtetim është i vlefshëm gjatë gjithë vitit, në rast se kërkesa për marrje të certifikatave dhe dokumenteve zyrtare nuk mund të dorëzohet menjëherë pas pagesës së taksës
5. Për lëshimin e dokumenteve të gjendjes civile për përdorim jashtë vendit, ato lëshohen në letër të veçantë sipas specifikave të përcaktuara nga Agjencia e Regjistrimit Civil
6. Për përdorim të brendshëm, dokumentet e gjendjes civile lëshohen në letër të bardhë të formatit A4.

Neni 9

Detyrimi lidhur me të dhënat

1. Të gjithë personat që kërkojnë të pajisen me certifikatat e parapara nga neni 7 i kësaj rregulloreje duhet të ofrojnë të dhënat lidhur me regjistrin civil me kohë dhe t'i përditësojnë ato brenda afatit të përcaktuar ligjor (Projekt-Rr... p. 8). Po ashtu, duhet të ofrojnë informata të sakta lidhur me gjendjen përkatëse për të cilën pajisen me vërtetim.

KAPITULLI IV

Neni 10

DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK

Taksat (ngarkesat) për ushtrimin e veprimtarive afariste

1. Taksat vjetore për ushtrimin e veprimtarisë afariste sipas kategorive

Nr.	EMËRTIMI (i tarifës dhe taksave në shërbime)	Tarifa
1.1	Kompanitë publike nacionale	500 €
1.2	Kompanitë publike regjionale	500 €
1.3	Kompanitë dhe filialet bankare	5000 €

1.4	Kompanitë mikrofinanciare dhe mikrokreditore	4000 €
1.5	Kompanitë e pagesave mikrofinanciare jobankare	500 €
1.6	Kompanitë dhe filialet e kompanive që merren me sigurimin e automjeteve, pasurisë, personave dhe sigurimeve të tjera	500 €
1.7	Kompanitë që merren me sigurimin fizik	1000 €
1.8	Kompanitë dhe korporatat e ndryshme rentabile	5000 €
1.9	Ndërmarrjet ndërtimore - ndërtimi i lartë	5000 €
1.10	Ndërmarrjet ndërtimore - ndërtim i ulët	1000 €
1.11	Ndërmarrjet e specializuara për ndërtim	1000 €
1.12	Ndërmarrësit e vegjël	50 €
1.13	Prodhuesit e pijeve alkoolike	50 €
1.14	Prodhuesit e pijeve joalkoolike	50 €
1.15	Prodhuesit e materialit ndërtimor	300 €
1.16	Prodhuesit dhe përpunuesit e lëkurës dhe materialeve të ngjashme	300 €
1.17	Prodhuesit e mobilieve	500 €
1.18	Prodhuesit e materialit për ambalazh nga plastika	100 €
1.19	Prodhuesit e materialit për ambalazh nga letra	100 €
1.20	Prodhuesit dhe përpunuesit e arit, argjendit dhe metaleve të tjera të çmuara	1000 €
1.21	Prodhuesit e materialit elektrik	100 €
1.22	Prodhuesit e gypave PVC	100 €
1.23	Prodhuesit e tekstitit, tepihëve dhe produkteve të tjera të ngjashme	100 €
1.24	Prodhuesit e dymave, dritareve dhe elementeve të tjera të ngjashme nga alumini dhe plastika	1000 €
1.25	Prodhuesit e dymave, dritareve dhe elementeve të tjera të ngjashme nga druri	500 €
1.26	Prodhuesit e elementeve të metalit	1000 €

1.27	Prodhuesit e ngjitëseve dhe xhelatinës	100 €
1.28	Prodhuesit e fasadave, materialeve suvatuese dhe materialeve të tjera përcjellëse	1200 €
1.29	Prodhuesit e sfungjerit dhe materialeve të tjera të ngjashme	100 €
1.30	Prodhuesit e produkteve të mishit	300 €
1.30.1	Përpunuesit e mishit dhe produkteve të mishit	500 €
1.31	Përpunuesit e qumështit dhe produkteve nga qumështi	300 €
1.32	Prodhuesit dhe përpunuesit e produkteve ushqimore	200 €
1.33	Prodhuesit e tjerë (produkteve higjienike, sanitare etj.)	200 €
1.34	Përpunimi i drurit, llamarinës, plastikës, gurit etj.	100 €
1.35	Shtypshkronjat	100 €
1.36	Ndërmarrjet botuese	100 €
1.37	Ndërmarrjet tregtare me shumicë	2000 €
1.38	Ndërmarrjet tregtare me pakicë	500 €
1.39	Depot e materialit ndërtimor	1000 €
1.40	Agjencitë turistike	400 €
1.41	Transportuesit e udhëtarëve (nacionalë dhe ndërkombëtarë)	700 €
1.42	Transportuesit e udhëtarëve (lokalë)	200 €
1.43	Transportuesit e materialeve të rrezikshme	1000 €
1.44	Transportuesit e materialeve ndërtimore	1000 €
1.45	Transportuesit specifikë	200 €
1.46	Ndërmarrjet e autotaksive	1000 €
1.47	Taksitë individuale (kanë një taksitë dhe punojnë pronarët)	50 €
1.48	Gurëthyesit dhe separacionet e rërës	6000 €
1.49	Hotelet	1000 €

1.50	Motelet, vilat	10000 €
1.51	Restorantet	1000 €
1.52	Piceritë	200 €
1.53	Bifet, gjellëtoret dhe servuesit e vegjël të ushqimit	200 €
1.54	Diskobaret	500 €
1.55	Klubet e natës	1000 €
1.56	DJ	200 €
1.57	Grupet muzikore	500 €
1.58	Kafe-çajtoret	100 €
1.59	Kafiteritë	250 €
1.60	Ëmbëltoret	250 €
1.61	Parkingjet private	500 €
1.62	Kompanitë e shpedicionit	1000 €
1.63	Tregjet e hapura dhe të mbyllura të tjera	200 €
1.64	Tregtia me pakicë e pajisjeve sportive në dyqane të specializuara	500 €
1.65	Tregtia tjetër me pakicë në dyqane jo të specializuara (mallrat e përdorura)	500 €
1.66	Tregtia me pakicë e mallrave të tjera të reja, në dyqane të specializuara (bizhuteri dhe kozmetikë)	500 €
1.67	Tregtia me pakicë e mallrave të tjera të reja, në dyqane të specializuara (sanitari, hekurishte, instalime të tjera)	500 €
1.68	Tregtia me pakicë e pajisjeve elektroshtëpiake në dyqane të specializuara	1000 €
1.69	Tregtia me pakicë e mallrave të reja, në dyqane të specializuara (të përziera)	700 €
1.70	Tregtia, shitja e dyerve dhe dritareve	700 €
1.71	Tregtia, shitja e mobilieve dhe kuzhinave	350 €

1.72	Tregtia me pakicë e mallrave të tjera (armëve, rekreacionit)	1000 €
1.73	Aktivitetet e tjera të argëtimit dhe rekreacionit (poligonet)	500 €
1.74	Aktivitetet e tjera shërbyese në mbështetje të bizneseve (reklamat)	500 €
1.75	Kompanitë ndërmjetësuese në pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme	1000 €
1.76	Fermat e shpendëve dhe kafshëve	50 €
1.77	Mullinjtë elektrikë me industrinë e përpunimit dhe prodhimit nga gruri	1000 €
1.78	Mullinjtë elektrikë	500 €
1.79	Barnatoret bujqësore	300 €
1.80	Barnatoret shëndetësore	500 €
1.81	Shërbimet veterinarë	50 €
1.82	Frigoriferët	150 €
1.83	Mishtoret	200 €
1.84	Thertoret	200 €
1.85	Bukëpjekësit	200 €
1.86	Përpunimi i pemëve dhe perimeve	100 €
1.87	Lulishtet	200 €
1.88	Pikat e karburanteve me 1-2 aparate	500 €
1.89	Pikat e karburanteve me mbi 3-6 aparate	1000 €
1.90	Pikat e karburanteve me mbi 6 aparate	2000 €
1.91	Depot e derivateve	7000 €
1.92	Pikat e gazit	2000 €
1.93	Radio	100 €
1.94	TV	100 €
1.95	Kioskat	100 €

1.96	Artizanati	50 €
1.97	Dyqanet	100 €
1.98	Marketet	300 €
1.99	Supermarketet	1500 €
1.100	Qendrat tregtare	4000 €
1.101	Tregtia e produkteve të qumështit	350 €
1.102	Tregtarët lëvizës	50 €
1.103	Produksionet e artit, dizajnit	300 €
1.104	Autoserviset: Automekanikë, autolimarë, elektrikistë	500 €
1.105	Autoserviset automekanikë	500 €
1.106	Autoserviset autolimarë	500 €
1.107	Autoserviset elektrikistë	150 €
1.108	Vullkanizerët	400 €
1.109	Riparimi dhe servisimi i pajisjeve elektrike, elektronike dhe informative	200 €
1.110	Autolarjet (100 euro) dhe autolarjet vetëshërbim	150 €
1.111	Kontrollimi teknik i automjeteve	1000 €
1.112	Rent a Car deri në 5 vetura	150 €
1.113	Rent a Car nga 6 deri 10 vetura	300 €
1.114	Rent a Car nga 11 deri në 20 vetura	600 €
1.115	Rent a Car mbi 20 vetura	1500 €
1.116	Tregtia e automjeteve të reja	1500 €
1.117	Tregtia e automjeteve të përdorura	1000 €
1.118	Varrezat e automjeteve, shitja e pjesëve të vjetra	1000 €
1.119	Varrezat dhe rekuperuesit e mbeturinave të metaleve	1000 €

1.120	Varrezat dhe rekuveruesit e mbeturinave jometaleve	500 €
1.121	Shërbimet e internetit dhe TV kabllor	2500 €
1.122	Shërbimet e elektrikës, elektronikës, sistemeve të sigurisë etj.	300 €
1.123	Lojërat e ndryshme (bilardo, video-lojëra dhe të ngjashme)	100 €
1.124	Pishinat	500 €
1.125	Fusha sportive të hapura	200 €
1.126	Fusha sportive të mbyllura	300 €
1.127	Shërbimet e pastrimit	200 €
1.128	Dhënia me qira e mjeteve të punës	50 €
1.129	Riparimi i makinave të imëta	50 €
1.130	Floktarët për meshkuj dhe për femra	150 €
1.131	Sallonet e ondulimit	300 €
1.132	Fotografët	200 €
1.133	Pastrimi kimik	100 €
1.134	Përpunuesit e mermerit dhe granitit	700 €
1.135	Ndërmarrjet për instalimet e ujit, kanalizimit dhe ngrohjes qendrore	500 €
1.136	Veprimtaritë e tjera profesionale	100 €
1.137	Ndërmarrjet e tjera shërbyese	100 €
1.138	Agjencitë e tjera profesionale	100 €
1.139	Avokatët	300 €
1.140	Shërbimet juridike	100 €
1.141	Përkthyesit	200 €
1.142	Ordinancat mjekësore private	600 €
1.143	Spitalet	1500 €

1.144	Klinikat mjekësore	500 €
1.145	Laboratorët	500 €
1.146	Autoshkollat	500 €
1.147	Rëntgeni	600 €
1.148	Dentistët	500 €
1.149	Noterët	1500 €
1.150	Shërbimet e kontabilitetit dhe financave	200 €
1.151	Auditorët	1000 €
1.152	Kompanitë projektuese	800 €
1.153	Arsimi parashkollor dhe çerdhet	300 €
1.154	Arsimi fillor	500 €
1.155	Arsimi i mesëm	500 €
1.156	Arsimi universitar	1000 €
1.157	Arsimi tjetër dhe kurset	150 €
1.158	Libraritë	150 €
1.159	Fizioterapeutët	400 €
1.160	Fitneset në ambiente të mbyllura	200 €
1.161	Fitneset në ambiente të hapura	100 €
1.162	Kompanitë që merren me vlerësim të dëmit dhe sigurisë	200 €
1.163	Vlerësuesit e licencuar për vlerësime të ndryshme	200 €
1.164	Gjeodetët dhe ndërmarrjet që merren me matje gjeodezike	500 €
1.165	Ndërmarrjet që merren me rregullimin e rrugëve dhe kanalizimeve	500 €
1.166	Rrobaqepësit	50 €
1.167	Ndërmarrjet që merren me qepje dhe shitje të produkteve të tekstitit	200 €

1.168	Shitja dhe servisimi i telefonave mobilë dhe pajisjeve përcjellëse të tyre	300 €
1.169	Aktivitetet e lojërave të ndryshme për fëmijë	100 €

2. Duke u bazuar në specifikat e ndryshme ekonomike të komunës, e cila ndikon në afarizmin e bizneseve në Komunën e Fushë-Kosovës, janë **përcaktuar 5 zona që i referohen zonimit të Rregullores së tatimit në pronë**; zonat nga II deri në V kanë zbritje si më poshtë

2.1 Zona I ngarkohet sipas ngarkesave në listën e aktiviteteve.

2.2 Zona II ngarkohet me zbritje 10% nga ngarkesa në listën e aktiviteteve

2.3 Zona III ngarkohet me zbritje 20% nga ngarkesa në listën e aktiviteteve

2.4 Zona IV ngarkohet me zbritje 35% nga ngarkesa në listën e aktiviteteve

2.5 Zona V ngarkohet me zbritje 50% nga ngarkesa në listën e aktiviteteve.

Kodi	Përshkrimi i Shërbimit / Taksës	Tarifa
3.1	Certifikatat mbi kryerjen e obligimeve dhe certifikata të ngjashme	1.00 €
3.2	Certifikatat për kursime pensionale invalidore (zejtarët)	1.00 €
3.3	Certifikata për gjendjen ekonomike dhe financiare	1.00 €
3.4	Për mbajtjen e muzikës në lokale (taksa për orë pune)	25.00 €
3.5	Zgjatja e orarit të punës në ditë festash dhe jashtë orarit (për 1 orë)	25.00 €
3.6	Kërkesat për zvogëlimin e tarifë-ngarkesave	1.00 €
3.7	Kërkesa për vërtetim mbi të ardhurat dhe kërkesat e tjera për jashtë vendit	1.00 €

4. Tarifat për lejet e pronësisë së automjeteve

1. Për të gjithë pronarët, bizneset ose subjektet e tjera që kanë në pronësi të gjitha llojet e automjeteve motorike, të cilat regjistrohen dhe paguajnë sigurimin e automjeteve brenda vitit, tarifa caktohet si vijon:

Kodi	Lloji i Automjetit / Rimorkios	Tarifa
1.1	Automjetet deri në 3.5 tonë	10.00 €
1.2	Automjetet mbi 3.5 tonë	20.00 €
1.3	Autobusët	25.00 €
1.4	Motoçikletat	5.00 €
1.5	Rimorkiot e automjeteve mbi 3.5 tonë	10.00 €
1.6	Rimorkiot e automjeteve deri në 3.5 tonë	5.00 €
1.7	Makinat bujqësore	3.00 €

2. Taksa për lëshimin e lejes së lartpërmendur do të paguhet në Komunë me ngarkesë dhe në bazë vjetore ose me rastin e regjistrimit të automjeteve në qendrën për regjistrimin e automjeteve.
3. Vërejtje: Nga tarifa për leje të automjeteve motorike lirohen të gjitha automjetet e emergjencës (zjarrfikësit dhe makinat e ndihmës së shpejtë), familjet e dëshmorëve, invalidët e luftës, personat me aftësi të kufizuar dhe automjetet zyrtare. Provë për këtë është leja e qarkullimit të automjetit.
4. Tarifa për parkimin e automjeteve

Kodi	Lloji i Automjetit / Kohëzgjatja e Parkimit	Tarifa
5.1	Automjetet motorike deri në 3.5 t (për një orë)	1.00 €
5.2	Automjetet motorike mbi 3.5 t (për një orë)	2.00 €

Neni 11

Ankesat kundër taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste

1. Kundër vendimit të lëshuar nga DZHE-ja me taksë komunale për ushtrimin e veprimtarisë, pala e pakënaqur ka të drejtë të kërkojë shqyrtimin e vendimit brenda 30 ditëve nga dita e pranimit, duke iu drejtuar organit që ka nxjerrë vendimin

2. Pala e pakënaqur me vendimin e DZHE-së për ngarkesa dhe taksa komunale ka të drejtë ankese brenda 30 ditëve nga dita e pranimit të vendimit, duke iu drejtuar Komisionit Komunal për Shqyrtimin e Ankesave të formuar nga Kryetari i Komunës (Zyrtari më i lartë Administrativ)

KAPITULLI V
DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE
Neni 12

1. Tarifat në sferën e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale; kjo Drejtori realizon këto të hyra për tarifa nga qytetarët e Komunës së Fushë-Kosovës

Nr.	EMËRTIMI	Tarifa
1.1	Vërtetimi për nxënës dhe studentë për botën e jashtme (nga lëmia shëndetësore)	5.00 €
1.2	Vërtetimet mbi gjendjen shëndetësore të punëtorëve në botën e jashtme	8.00 €
1.3	Vërtetimet e llojeve të ngjashme të tjera (nga lëmia shëndetësore)	8.00 €
1.4	Raporte konziliare të mjekëve për punëtorë në botën e jashtme	15.00 €
1.5	Formulari për shpenzimet e varrimit	0 €
1.6	Formular për pensionistët që kanë vendim të pensionit deri në 150 €	0 €
1.7	Formular për pensionistët që kanë vendim të pensionit mbi 150 €	0 €

Neni 13
Dispozitat e veçanta (dispozitat lehtësuese, Lirimi nga tarifa)

1. Qytetarët të cilët u përkasin kategorive të qytetarëve si në vijim: Shfrytëzuesit e ndihmës sociale; familjet e dëshmorëve dhe të zhdukurve të UÇK-së; invalidët e luftës së UÇK-së dhe anëtarët e familjes së ngushtë; veteranët e luftës së UÇK-së dhe anëtarët e familjes së ngushtë; personat me aftësi të kufizuara; familjet strehuese të fëmijëve pa kujdes prindëror, lirohen nga pagesa e vërtetimit dhe dokumenteve zyrtare të taksave komunale administrative
2. Lirimi nga tarifa sipas kësaj rregulloreje bëhet pasi pala të prezantojë dëshmi valide me shkrim për statusin përkatës.

Neni 14
Tarifat në Qendrën për Punë Sociale - QPS

Kodi	Lloji i Shërbimit në QPS	Tarifa
1.1	Vërtetim për posedim të zotësisë së veprimit për pajisje për leje të armës	10.00 €
1.2	Vërtetim për posedim të zotësisë së veprimit për punësim	1.00 €
1.3	Vërtetim për lirim nga shtetësia e Kosovës që nuk ka obligime financiare	5.00 €
1.4	Vërtetim për praninë të shtetësisë së Kosovës	1.00 €
1.5	Vërtetim për palën se nuk është shfrytëzues/e i/e ndihmës sociale	1.00 €
1.6	Vërtetim për palën se ka qenë shfrytëzues/e i/e ndihmës sociale	1.00 €
1.7	Vërtetim për palën se nuk është shfrytëzues/e i/e ndihmës sociale - për shtet të jashtëm	5.00 €
1.8	Pëlqim për martesë para moshës madhore	5.00 €
1.9	Vërtetim për regjistrim të mëvonshëm të fëmijës	3.00 €
1.10	Vërtetim që është duke u kujdesur për fëmijët	1.00 €

Neni 15
QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE "Fatmir Krasniqi" (QKMF-ja)

Me anë të kësaj rregulloreje përcaktohen dhe sigurohen të gjitha të hyrat financiare nga bashkëpagesat që realizohen në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, nga shfrytëzuesit e shërbimeve shëndetësore, si dhe dispozitat e veçanta me anë të cilave parashihen kategoritë e shfrytëzuesve të shërbimeve shëndetësore që përjashtohen nga këto bashkëpagesa (Me dispozita ligjore dhe udhëzime administrative në fuqi, shfrytëzuesit potencialë (që në ndonjë mënyrë nuk janë liruar nga shfrytëzimi i shërbimeve shëndetësore) janë të obliguar të paguajnë taksën për ofrimin e shërbimit shëndetësor në QKMF Këta shfrytëzues të shërbimeve shëndetësore obligohen të participojnë për këto shërbime të paraqitura në mënyrë tabelare, si më poshtë.

Kodi	Emërtimi i Tarifës dhe Shërbimit	Tarifa
1.1	Ekzaminimi mjekësor nga mjeku i përgjithshëm (doktori i mjekësisë)	1.00 €
1.2	Ekzaminimi mjekësor nga specialisti i mjekësisë familjare	2.00 €
1.3	Ekzaminimi në shtëpi (përveç në rastet emergjente)	5.00 €
1.4	Medikamenti nga Lista Esenciale, ofruar në barnatoren publike	0.00 €
1.5	Ultrazëri standard	2.00 €
1.6	Radiografia	2.00 €
1.7	Analizat laboratorike (vetëm hemogrami dhe urina)	1.00 €
1.8	Analizat laboratorike (komplet)	3.00 €
1.09	Analiza laboratorike komplet me teste reumatike ose elektrolite	3.00 €
1.10	Përcaktimi i TSH, T3 dhe T4	3.00 €
1.11	Hemoglobina e glukozuar HbA1c (opsioni 1)	1.00 €
1.12	Analiza laboratorike HbA1c (opsioni 2)	3.00 €
1.13	Caktimi i sheqerit në gjak me glikometër sipas kërkesës së palës	1.00 €
1.14	Shpëlarja e veshit	1.00 €
1.15	Dhënia e injeksionit intramuskular në shtëpi (përveç në rastet emergjente)	1.00 €
1.16	Dhënia e injeksionit intravenoz në shtëpi (përveç në rastet emergjente)	1.00 €
1.17	Dhënia e infuzionit intravenoz në shtëpi (përveç në rastet emergjente)	1.00 €

1.18	Trajtimi ditor me infuzione në institucionin shëndetësor	1.00 €
1.19	Certifikata mjekësore e lëshuar sipas kërkesës së shfrytëzuesit (Sipas çmimoreve unike)	18.00€
1.20	Ofrimi i shërbimeve shëndetësore gjatë aktiviteteve sportive (për 1 orë)	25.00 €
1.21	Shtetasit e huaj dhe bartësit e sigurimeve të huaja shëndetësore do t'i paguajnë shërbimet e ofruara pesë herë më shtrenjtë sesa shtetasit e Republikës së Kosovës. Për një shërbim që ka bashkëpagesë, shtetasi i huaj ose bartësi i sigurimit të huaj shëndetësor do të paguajë:	5€ 10€

1. Tarifa në shërbimet stomatologjike:

Neni 16

Nr.	EMËRTIMI (i tarifës dhe taksave në shërbime)	Euro (€)
1.1	Vizita nga mjeku i stomatologjisë	1.00 €
1.2	Vizita nga specialisti i stomatologjisë (ortodonti, pedodonti etj.)	2.00 €
1.3	RTG i dhëmbit	1.50 €
1.4	Mbushja e përhershme me amalgamë	4.00 €
1.5	Mbushja e përhershme me kompozitë	5.00 €
1.6	Shërimi biologjik i dhëmbit me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë)	5.00 €
1.7	Amputimi vital i pulpës me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë)	5.00 €
1.8	Ekstirpimi vital i pulpës me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë)	5.00 €
1.9	Amputimi mortal i pulpës me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë)	5.00 €
1.10	Ekstirpimi mortal i pulpës me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë)	5.00 €
1.11	Terapia e kanalit të infektuar me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë)	5.00 €

1.12	Rindërtimi konservativ i dhëmbit me mbushje të përhershme	5.00 €
1.13	Revizioni i mbushjes së kanalit të rrënjës	1.00 €
1.14	Fluorizimi i dhëmbëve sipas seancave	1.00 €
1.15	Vulosja e fisurave	1.00 €
1.16	Mënjanimi i depozitimeve të buta	1.00 €
1.17	Mënjanimi i depozitimeve të forta (heqja e gurëzve të dhëmbëve me ultratingull)	3.00 €
1.18	Kiretazha e xhepave parodontalë (një dhëmb)	1.00 €
1.19	Nxjerrja e dhëmbit	1.50 €
1.20	Incizioni intra dhe ekstraoral	1.50 €
1.21	Heqja e kurorës me anë të prerjes	1.00 €
1.22	Riparimi i protezës (ngjitja)	1.50 €
1.23	Zëvendësimi i dhëmbit të humbur në protezë (deri në tri dhëmbë)	3.00 €
1.24	Riparimi i aparatit ortodontik	3.00 €
1.25	Shërimi i alveolitit (me seanca)	1.50 €
1.26	Shtetasit e huaj dhe bartësit e sigurimeve të huaja shëndetësore do të paguajnë shërbimet e ofruara pesë herë më shtrenjtë sesa shtetasit e Republikës së Kosovës, për një shërbim që ka bashkëpagesë. Shtetasi i huaj ose bartësi i sigurimit të huaj shëndetësor do të paguajë:	5.00 € / 10.00 €
1.27	Banorët e Luginës së Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës për shërbimet e ofruara mjekësore.	1.00 €

Neni 17

Dispozitat e veçanta (dispozitat lehtësuese apo liruese):

Përfshirimi nga bashkëpagesat (tarifë-ngarkesat). Shërbimet shëndetësore dhe grupet e popullatës që janë të liruar nga bashkëpagesat janë:

1.1 Fëmijët dhe të rinjtë deri në moshën 15-vjeçare;

1.2 Nxënësit dhe studentët deri në përfundim të shkollimit të rregullt (mosha maksimale për studentët është 26 vjeç);

1.3 Të moshuarit (mbi 65 vjeç);

- 1.4 Personat me nevoja të veçanta;
- 1.5 Anëtarët e familjeve të dëshmorëve dhe të zhdukurve të UÇK-së, invalidët e luftës dhe anëtarët e familjes së ngushtë të tyre, anëtarët e viktimave civile të luftës, të marrëve peng apo të zhdukur në periudhën e luftës, veteranët dhe anëtarët e familjes së tyre të ngushtë dhe viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës;
- 1.6 Rastet sociale (shfrytëzuesit e ndihmës sociale të të dyja kategorive);
- 1.7 Dhuruesit e rregullt të gjakut që posedojnë dëshmi nga Qendra Kombëtare për Transfuzion të Gjakut e Kosovës;
- 1.8 Kategori të tjera sipas diagnozës (të përcaktuara me ligj dhe akte nënligjore nga Ministria e Shëndetësisë);
- 1.9 Kujdesi shëndetësor parandalues;
- 1.10 Kujdesi shëndetësor reprodaktiv që përfshin masat e planifikimit të familjes dhe kujdesin shëndetësor gjatë shtatzënisë, lindjes dhe lehonisë;
- 1.11 Kujdesi shëndetësor për qytetarin në stadin terminal duhet të ofrohet në shtëpinë e qytetarit/pacientit nga ana e Qendrës së Mjekësisë Familjare;
- 1.12 Diabet Melitus Tip I (pacientët e varur nga insulina) E 10;
- 1.13 Të sëmurët në dializë;
- 1.14 Psikozat kronike si: Skizofrenia (ICD 10, F-20) ose çrregullimi bipolar;
- 1.15 Të sëmurët nga (ICD-10: F-13) retardimet e rënda mendore;
- 1.16 Të sëmurët nga tuberkuloza;
- 1.17 Sëmundjet malinje (C 00 - D 48);
- 1.18 Të sëmurët nga AIDS-i;
- 1.19 Të sëmurët me paraplegji ose tetraplegji, personat e verbër dhe shurdhmemecë;
- 1.20 Të gjitha femrat që bëjnë mamografinë që ofrohet nga QKMF-ja;
- 1.21 Të gjithë zjarrfikësit dhe anëtarët e familjes së ngushtë të tyre;
- 1.22 Të gjithë punëtorët e kompanisë rajonale "Pastrimi";
- 1.23 Vizita e përsëritur brenda 5 ditëve;
- 1.24 Certifikatat e gjendjes shëndetësore të nevojshme për vijimin e rregullt të vitit mësimor në të gjitha nivelet e arsimimit;
- 1.25 Të burgosurit politikë.

KAPITULLI VI

Neni 18

DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN

1. Taksat (tarifat) e përgjithshme:

Nr.	EMËRTIMI	Tarifa
1.1	Për aktin e lëshimit të lejes së ndërtimit për objektet e kategorisë së I-rë dhe të II-të (sipas Ligjit të ndërtimit Nr. 04/L-110)	10.00 €
1.2	Taksa administrative për lëshimin e lejeve për shndërrim të banesave në lokale afariste, dhe lokaleve afariste në banim	10.00 € / m ²
1.3	Ndërtimi i objekteve të infrastrukturës. Për aktin me të cilin lejohet kyçja në infrastrukturën komunale si: rrjet i ujësjellësit, rrjet i kanalizimit, rrjet kabllor i	

	tensionit të ulët (si tërësi për aktvendim), sipas nënpikave 1.3.1, 1.3.2 dhe 1.3.3 të kësaj rregulloreje paguhet:	
1.3.1	Për persona fizikë	15.00 €
1.3.2	Për personin fizik që ka biznes individual	150.00 €
1.3.3	Për persona juridikë	150.00 €
1.4	Për aktin me të cilin lejohe grupimi për ndërtimin e infrastrukturës si:	
1.4.1	Rrjet i ujësjellësit	0.80 € / m ²
1.4.2	Rrjet i kanalizimit	0.80 € / m ²
1.4.3	Rrjet rrugor	1.00 € / m ²
1.4.4	Rrjet elektrik - Infrastrukturë nëntokësore Infrastrukturë mbitokësore (ajrore)	1.00 € / m ² 1.00 € / m ²
1.4.5	Për vendosjen e paneleve solare (Kjo tarifë nuk aplikohet për panelet solare që janë të liruara sipas Udhëzimit Administrativ)	2.0 % e vlerës investive
1.5	Për aktin me të cilin lejohe grupimi për ndërtimin e trasave kablore dhe ajrore të infrastrukturave si:	
1.5.1	Rrjet i telekomunikacionit dhe televiziv	1.00 € / m ²
1.5.2	Rrjet i termofikimit	0.40 € / m ²
1.5.3	Rrjet kabllor (internet) – Infrastrukturë nëntokësore Infrastrukturë mbitokësore (ajrore)	1.00 € / m ² 1.00 € / m ²
1.6	Për aktin me të cilin lejohe ndërtimi i objekteve të infrastrukturës si:	
1.6.1	Antenë (GSM)	1000.00 € / copë
1.6.2	Antenë – internet e të ngjashme	800.00 € / copë
1.7	Tarifa dhe ngarkesat për bizneset që furnizojnë dhe që furnizohen:	
1.7.1	Tarifa dhe ngarkesat për bizneset që veprojnë në zonën urbane: Parking i përkohshëm për furnizim me material – pagesa mujore	20.00 €

1.7.2	Tarifa dhe ngarkesat për furnitorët të cilët furnizojnë bizneset që veprojnë në zonën urbane: Parking i përkohshëm për furnizim me material – pagesa mujore	50.00 €
1.8	Tarifa për dhënien e pëlqimeve dhe vërtetimeve të ndryshme:	
1.8.1	Dhënia e pëlqimit për parcializim të pronave (për parcelë)	15.00 €
1.8.2	Zgjatja e afatit të kushteve ndërtimore dhe lejes së ndërtimit	100.00 €
1.8.3	Dhënia e ekstrakteve nga zgjidhjet urbanistike, vërtetimeve të ndryshme dhe shërbimeve të tjera	10.00 €
1.8.4	Aktvendim për leje rrënimi të objekteve	50.00 €
1.8.5	Pëlqime të ndryshme	15.00 €
1.8.6	Për renovime të brendshme dhe të jashtme të objekteve	2.0 % e vlerës investive
1.9	Tarifa për shfrytëzim të sipërfaqeve (hapësirave) publike sipas zonave paguajnë tarifën mujore si vijon:	
A.	Zona e I-rë:	
1.9.1	Objektet hoteliere, ëmbëltoret etj. (para objektit)	3.00 € / m ²
1.9.2	Aparatet për patate të skuqura (pomfrit), krofne, petulla (palaçinka) etj.	4.50 € / m ²
1.9.3	Aparatet për akullore dhe ruajtjen e tyre	6.00 € / m ²
1.9.4	Auto-dyqani lëvizës	6.00 € / m ²
1.9.5	Ormanët MDF – pikat shpërndarëse të internetit	10.00 € / m ²
1.9.6	Gjeneratorët statikë	5.00 € / m ²
1.9.7	Tendat (çadrat) e hapura lëvizëse me mekanizëm	1.00 € / m ²
1.9.8	Vendosja e lojërave të fëmijëve – tarifa vjetore	3.00 € / m ²
1.9.9	Tendat për shitjen e produkteve të ndryshme	3.00 € / m ²
1.9.10 Për shfrytëzim të hapësirës publike për parking		3.00 € / m²

B. Zona II (përfshin hapësirat publike që kanë qasje në rrugët, si dhe hapësirat publike të cekura në Zonën I po që nuk kanë qasje direkte në rrugët e specifikuar të Zonës I) – tarifa zbritet për 20 %; dhe Zona III (përfshin të gjitha hapësirat publike të cilat nuk janë specifikuar në Zonën I dhe II, duke përfshirë edhe hapësirat publike komunale në vendbanimet rurale) – tarifa zbritet për 25 %.

1.10	Për ekspozimin e panove reklamuese paguhen tarifat vjetore si më poshtë:	
1.10.1	Ekspozimi i panove reklamuese dhe muraleve në qytet	40.00 € / m ²
1.10.2	Ekspozimi i panove reklamuese dhe muraleve me ndriçim në qytet	50.00 € / m ²
1.10.3	Ekspozimi i panove reklamuese jashtë zonës urbane	15.00 € / m ²
1.10.4	Ekspozimi i panove reklamuese me ndriçim jashtë zonës urbane	20.00 € / m ²
1.10.5	Ekspozimi i reklamave në automjete	10.00 € / m ²
1.10.6	Vendosja e ekraneve elektronike reklamuese	60.00 € / m ²
1.10.7	Vendosja e reklamave në shtyllat e ndriçimit publik: 1. Tarifa mujore 2. Tarifa ditore	30.00 € / m ² 5.00 € / m ²
1.10.8	Ekspozimi i panove reklamuese dhe muraleve sipas pozitave të lartpërmendura në pronat private paguhet 50 % e vlerave të lartpërmendura.	
1.11	Shfrytëzimi i sipërfaqeve publike për aparatet dhe shtatorët e lojërave argëtuese, kompensimi paguhet si vijon:	

1.11.1	Për vendosjen e cirkut tarifa ditore është:	Deri në 30 m ² pagesa është 20.00 €; Mbi 30 m ² pagesa është 30.00 €.
1.11.2	Për vendosjen e të gjitha llojeve të aparateve e shtatoreve të tjera të lojërave argëtuese, tarifa ditore është:	Deri në 30 m ² pagesa është 20.00 €;

		Mbi 30 m ² pagesa është 30.00 €.
1.11.3	Marketingu, tendat për promovimin e produkteve, pavijonet – tarifa ditore:	10.00 €
1.11.4	Pagesa ditore për shitësit ambulantë (shitjen e luleve dhe gjërave të tjera të ngjashme) 1.00 deri në 20.00 m ² :	20.00 €
1.12	Për dalje në vendngjarje sipas detyrës zyrtare dhe me kërkesën e palëve, bëhet kompensimi për shërbime urbanistike:	
1.12.1	Për persona fizikë	10.00 €
1.12.2	Për personin fizik që ka biznes individual	25.00 €
1.12.3	Për persona juridikë, ndërmarrje etj.	25.00 €

Të gjitha kategoritë e lejes së ndërtimit 1 dhe 2, vlejné tarifat sipas Ligjit të Planifikimit Hapësinor Nr. 02/2018 mbi taksën administrative	Vlera sipas pëlqimit të MMPHI dhe vendimit
1.14 Taksë për leje mjedisore komunale sipas UA LMK 01/2017	Bazuar në vlerën investive
1.15 Për të gjitha lejet e ndërtimit për objektet që i nënshtrohen legalizimit vlejné tarifat e lartshënuara, ndërsa ndëshkimet caktohen konform ligjeve të aplikueshme.	

Neni 19

Dispozitat lehtësuese në Drejtorinë e Urbanizmit (nuk do të paguhen):

1. Për objektet e vjetra (që kanë poseduar leje ndërtimi më parë) dhe të dëmtuara nga lufta e të ngritura legalisht për të njëjtin gabarit, kurse për diferencën po.
2. Për objektet arsimore, administrative, sportive, shëndetësore si qendrat rekreative etj., që ndërtohen me mjete buxhetore, investime të komunitetit apo me donacione të organizatave e që janë në interes të përgjithshëm që financohen nga buxheti i Kosovës dhe donatorët.
3. Për objektet e kultit fetar, varreza, lapidare, sipërfaqe të hapura, gjelbërim, për parking publik, sheshe, rrugë dhe sipërfaqe për gjelbërim publik.
4. Bujqit lirohen nga të gjitha tarifatat e lartcekura, përfshirë edhe taksat administrative dhe taksat për rregullim të infrastrukturës për ndërtimin e objekteve bujqësore (fermat).

5. Për shfrytëzim të hapësirës publike për çështje humanitare të lirohen nga taksa komunale dhe administrative (duke i përfshirë organizatat jofitimprurëse dhe të huaja).

KAPITULLI VII

Neni 20

DREJTORIA PËR BUJQËSI, ZHVILLIM RURAL

1. Tarifa për ndërrimin e destinimit të përhershëm të tokës bujqësore:

Nr. Emërtimi i kategorisë së tokës Vlera

1.1 A \ Klasa I–IV	1.00 € / m ²
1.2 B \ Klasa V–VI	0.75 € / m ²
1.3 C \ Klasa VII–VIII	0.50 € / m ²

2. Për ndërrimin e përkohshëm të destinimit të tokës bujqësore do të paguhet kompensimi 20% nga taksat e destinimit të përhershëm, përveç nëse me ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

2.1 Kompensimi i tokës bujqësore nuk paguhet për objekte të cilat financohen nga buxheti komunal dhe shtetëror.

3. Tarifa për shërbimet profesionale në përzgjedhjen dhe damkimin e trungjeve dhe lëshimin e lejeve për prerje në pyjet private dhe publike:

3.1 Damkimi i trungjeve për prerje në pyjet private bëhet nga Agjencioni Pyjor i Kosovës në pajtim me planet vjetore të menaxhimit dhe në pajtim me mundësitë vjetore të shfrytëzimit të ngastrave.

3.2 Të gjitha procedurat e lëshimit të lejes për prerje në pyjet private, duke përfshirë shqyrtimin e kërkesës, dhënien e lejes për prerje, shënjimin e asortimentit për transport dhe lëshimin e fletëpërcjelljes, udhëhiqen nga Autoriteti Pyjor Komunal.

3.3 Për përzgjedhjen, damkimin dhe lëshimin e lejeve për prerjen e trungjeve të klasifikuara si asortiment teknik (industrial) dhe për trungje të klasifikuara si dru për djegie, do të zbatohen tarifat si në vijim:

4. Taksat për shërbimet profesionale për prerje të pyjeve private, dhënien e pëlqimeve, vërtetimeve nga lëmia e bujqësisë dhe pasurive të tjera bujqësore:

Nr.	Kategorizimi i dokumentit	Vlera në €
4.1	Fletëpagesa për damkosje të druve në pyje private me $(v = 7 \text{ m}^3)$	1.50 € / m ³
4.2	Fletëpagesa për damkosje të druve në pyje private me $(v = 7 \text{ m}^3)$	2.00 € / m ³

4.3	Fletëpagesa për dru teknik (industrial) për m ³	3.00 € / m ³
4.4	Fletëpagesa për pyje publike – dru të thata-holla $\{(d = 7\text{cm})\}$	11.00 € / m ³
4.5	Fletëpagesa për pyje publike – dru të thata-trasha mbi $\{(d = 7\text{cm})\}$	15.00 € / m ³
4.6	Për punën e komisionit në vlerësimin e dëmit të pyllit, vreshtave, pemishteve, kulturave lavërtare, bagëtisë dhe pasurive të tjera	10.00 €
4.7	Vërtetim për shitjen e prodhimeve bujqësore në treg për një vit	15.00 €
4.8	Vërtetim për bartjen e kafshëve për kokë	1.00 €
4.9	Trajtimi i qenve endacakë dhe shtëpiakë me kërkesë të pronarit	10.00 €
4.10	Vërtetim për të dëshmuar se një fermer merret apo është marrë me aktivitet bujqësor	1.00 €
4.11	Për lëshimin e çdo vërtetimi që nuk është paraparë në këto tarifa dhe ngarkesa	2.00 €

4. Taksa vjetore për shfrytëzimin e kullotave për bagëtitë në pyje dhe toka pyjore publike është:

Kullota publike mund të jepet në shfrytëzim me kontratë të lidhur me organin përgjegjës për menaxhimin e kullotave dhe personat e interesuar për marrjen e kullotave në shfrytëzim në bazë të kriterëve në bazë të UA dhe me kontratë për dhënie në shfrytëzim.

Nr.	Lloji i bagëtisë	NB/kokë	EURO/kokë
5.1	Gjedhe mbi një vit	1	1.20 € / copë
5.2	Viça	0.45	0.54 € / copë
5.3	Dele	0.18	0.22 € / copë
5.4	Qengja	0.1	0.12 € / copë
5.5	Kuaj dhe gomarë	1	1.20 € / copë
5.6	Derra	0.3	0.36 € / copë
5.7	Rosat	0.014	0.02 € / copë

5.8	Dosat	0.5	0.60 € / copë
-----	-------	-----	---------------

5. Përpos taksave dhe ngarkesave të caktuara në nenin 23, paragrafët 1, 2, 3, 4 dhe 5 të kësaj rregulloreje, do të aplikohen edhe taksat që caktohen nga Ministria përkatëse me aktet nënligjore të aplikueshme.

KAPITULLI VIII

Neni 21

DREJTORIA E INSPEKTORATIT

1. Taksat për lëshimin e dokumenteve zyrtare:

1.1 Shpenzimet për dalje të organeve të inspektimit të nivelit lokal në terren me kërkesën e palës për shikimin e objekteve (lokale të punës, pajisjeve, veglave, stabilimenteve etj.) të parapara me dispozitat për kushtet minimale higjieno-sanitare dhe teknike, si dhe të mbrojtjes së mjedisit, i bart parashtruesi i kërkesës si vijon:

Nr. R.	EMËRTIMI (i tarifave dhe taksave në shërbime)	Euro (€)
1.1.1	Për objektet lokale të punës në sipërfaqe deri në 20 m ²	20.00 €
1.1.2	Për objektet lokale të punës në sipërfaqe mbi 20–50 m ²	30.00 €
1.1.3	Për objektet lokale të punës në sipërfaqe mbi 50–100 m ²	40.00 €
1.1.4	Për objektet lokale të punës në sipërfaqe mbi 100 m ²	100.00 €

1.1.5	Kërkesë për inspektimet e fazave të objekteve të ndërtimit	10.00 €
1.1.6	Kërkesa për inspektim final të objektit (pranim teknik)	500.00 €
1.1.7	Kërkesë për kontroll inspektues për persona fizikë	5.00 €
1.1.8	Kërkesë për kontroll inspektues për persona fizikë që kanë të regjistruar biznes (individual) në bazë të legjislacionit në fuqi	10.00 €
1.1.9	Kërkesë për kontroll inspektues për subjekte afariste (persona juridikë) dhe institucionet e tjera	15.00 €

1.1.10	Aktvendimi për kushtet teknike	20.00 €
--------	--------------------------------	---------

2. Lartësia dhe pagesa e taksës komunale për Linjat Urbane dhe Autotaksi:

2.1 Çdo operator i transportit publik të udhëtarëve, pas pajisjes me licencë, obligohet të pajiset edhe me rend udhëtimi dhe paguan taksën vjetore për vija urbane dhe urbane-periferike.

2.2 Çdo person fizik dhe juridik që ka të regjistruar ushtrimin e veprimtarisë së shërbimeve të taksisë duhet të pajiset me leje pune dhe paguan taksën vjetore për leje pune.

2.3 Operatorët dhe personat fizikë të përcaktuar në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, taksën e paguajnë para marrjes së rendit të udhëtimit dhe lejes së punës sipas legjislacionit në fuqi.

KAPITULLI IX

Neni 22

DREJTORIA PËR ARSIM

1. Tarifat e përgjithshme në arsim:

Nr.	EMËRTIMI	Tarifa
1.1	Tarifa mujore për një fëmijë në çerdhe publike	45.00 €
1.2	Tarifa për regjistrimin e vitit shkollor për arsimin profesional joformal	100.00 €
1.3	Tarifa për provimet përfundimtare të klasës, certifikata, për mësimin joformal	30.00 €
1.4	Tarifa për diploma të përfundimit të shkollimit, për mësimin joformal	20.00 €
1.5	Tarifa për dokumentet duplikat për shkollat e mesme, për çdo diplomë paguhet	1.00 €
1.6	Tarifa për diplomë duplikat për shkollat e mesme	3.00 €
1.7	Tarifa për praktikë profesionale	50.00 €
1.8	Tarifa për provimin diferencial	10.00 €

Neni 23

Dispozitat e veçanta (dispozitat lehtësuese apo liruese):

1. Kur familja ka dy fëmijë në institucionin parashkollor, do të paguajë për njërin tarifën e plotë, ndërsa për të dytin 30 % më pak.
2. Nëse familja ka 3 fëmijë në institucionin parashkollor, për të tretin do të paguajë 50 % të tarifës.
3. Për çdo zbritje të tarifave, kompensimin e bën DKA-ja.
4. Nëse familja e ngushtë ka mbi dy studentë në shkollim, e gjithashtu ka edhe tre anëtarë të paaftë për punë, u zbritet tarifa prej 20 %, praktikisht do të paguajnë vetëm 80 %.
5. Shfrytëzimi i sallave të sportit nga ana e klubeve sportive apo grupeve të organizuara të cilat nuk janë nga komuna jonë, për qëllime komerciale dhe jokomerciale, vlera e pagesës është 15.00 € për orë.
6. Për dalim nga paragrafi 5 i këtij neni, shfrytëzimi i objekteve komunale për qëllime edukative, arsimore, shkencore dhe për qëllime të ngjashme sociale është i liruar nga pagesa.
7. Pagesa e taksës komunale për shfrytëzimin e përkohshëm të objekteve komunale sipas paragrafit 5 të këtij neni bëhet para marrjes në shfrytëzim të objektit.

KAPITULLI X

DREJTORIA PËR PRONË DHE DREJTORIA E KADASTËRIT E GJEODEZISË

Neni 24

Regjistrimi i të drejtës së pronësisë në bazë të vlerës së transaksioneve

1. Tarifa për regjistrimin e pronësisë sipas vlerës së transaksioneve është:
 - 1.1 Deri në dhjetë mijë (10.000)€.....tridhjetë (30) €;
 - 1.2 Prej dhjetë mijë e një (10.001) € deri në pesëdhjetë mijë (50.000) €
 - 1.3 Prej pesëdhjetë mijë e një (50.001) € deri në njëqind mijë (100.000) €..... shtatëdhjetë (70) €;
 - 1.4 Prej njëqind mijë e një (100.001) € deri në dyqind mijë (200.000) €nëntëdhjetë (90) €;
 - 1.5 Prej dyqind mijë e një (200.001) € deri në pesëqind mijë (500.000) €..... njëqind e njëzet (120) €;
 - 1.6 Prej pesëqind mijë e një (500.001) € deri në një milion (1.000.000) €..... dyqind e katërdhjetë (240) €;
 - 1.7 Mbi vlerën e një milioni (1.000.000) € tarifa..... pesëqind (500) €;
 - 1.8 Për vlerën e kontratës - transaksionit që është vërtetuar para vitit 1999 tarifa..... pesëdhjetë (50) €.
 - 1.9 Lirohen nga pagesa rastet kur kemi të bëjmë me reregjistrim të pronave të paluajtshme në kadastër.

2. Tarifat e përcaktuara nga paragrafi 1 i këtij neni, zbatohen në të gjitha rastet kur nuk është e përcaktuar me dispozitë të veçantë tarifa për regjistrim.

Neni 25

Tarifa e regjistrimit të pronësisë në bazë të kontratës mbi dhuratën

1. Tarifa për regjistrimin e pronësisë sipas kontratës së dhurimit për çdo anëtar të ngushtë të familjes:.....dhjetë (10) €.
2. Tarifa për regjistrimin e pronësisë sipas kontratës së dhurimit për çdo person që nuk është anëtar i familjes dhe që nuk është e caktuar vlera e pronës..... tridhjetë (30) €.
3. Tarifa për regjistrimin e pronësisë sipas kontratës për dhurimin e pronës së paluajtshme, në të cilën është caktuar vlera e pronës dhe dhuratëmarrësi nuk është anëtar i familjes, zbatohet tarifa sipas nenit 27 të kësaj rregulloreje.

Neni 26

Tarifa e regjistrimit të pronësisë në bazë të kontratës mbi mbajtjen e përhjetshme

1. Tarifa për regjistrimin e pronësisë sipas kontratës së mbajtjes së përhjetshme për personin që është anëtar i familjes tridhjetë (30) € për çdo pronar.
2. Tarifa për regjistrimin e pronësisë sipas kontratës së mbajtjes së përhjetshme për personin që nuk është anëtar i familjes dhe nuk është e caktuar vlera e pronës..... tetëdhjetë (80) €.
3. Tarifa për regjistrimin e pronësisë sipas kontratës për mbajtjen e përhjetshme, në të cilën është caktuar vlera e pronës dhe mbajtësi nuk është anëtar i familjes, zbatohet tarifa sipas nenit 27 të kësaj rregulloreje.

Neni 27

4. **Tarifa e regjistrimit të pronësisë apo të drejtave të tjera sendore në bazë të titullit juridik të organeve administrative dhe gjyqësore**
5. Tarifa për regjistrimin e të drejtës së pronësisë mbi pronën e paluajtshme apo të drejtave të tjera sendore në bazë të vendimit të organit administrativ apo gjyqësor.....tridhjetë (30) € për çdo pronar.

Neni 28

Tarifa për regjistrimin e bashkëpronësisë apo pronësisë së përbashkët

1. Tarifa për regjistrimin e të drejtës në bashkëpronësi apo pronësi të përbashkët për bashkëpronarin apo pronarin e përbashkët.....tridhjetë (30) €.
2. Tarifa për regjistrimin e të drejtës në pronësi të përbashkët për bashkëshortët..... tridhjetë (30) € për një titull juridik.

3. Tarifa për regjistrimin e njësisë kadastrale si pjesë e ndërtesës:..... njëzet e pesë (25) € për njësi.
4. Tarifa për regjistrimin e njësisë kadastrale të krijuar nga ndarja apo bashki..... njëzet (20) € për njësi.
5. Lirohet nga tarifa për regjistrimin e pronësisë së përbashkët të ndërtesave kolektive në bashkëpronësi.
6. Lirohet nga tarifa për regjistrimin e hapësirave të përbashkëta si njësi të veçanta.

Neni 29

Tarifa e regjistrimit të ndarjes së bashkëpronësisë apo pronësisë së përbashkët

1. Tarifa për regjistrimin e pronësisë në bazë të ndarjes nga bashkëpronësia apo pronësia e përbashkët për secilin bashkëpronar që bëhet pronar individual.....tridhjetë (30) €.
2. Lirohet nga tarifa për regjistrimin e ndarjes nga bashkëpronësia sipas nenit 6, paragrafi 3 dhe 4 i Udhëzimit Administrativ Nr. 12/19 për Ndarjen dhe Regjistrimin e Parcelës.

Neni 30

Tarifa e regjistrimit të pronësisë në bazë të trashëgimisë dhe të shkëputjes së bashkësisë familjare

1. Tarifa për çdo trashëgimtar për regjistrimin e pronësisë në bazë të trashëgimisë.....dhjetë (10) €.
2. Tarifa për çdo trashëgimtar për regjistrimin e pronësisë në bazë të trashëgimisë, e cila rrjedh nga testamenti..... njëzet (20) €.
3. Tarifa për regjistrimin e pronësisë në bazë të shkëputjes së bashkësisë familjare për çdo anëtar të familjes që bëhet pronar.....njëzet (20) €.

Neni 31

Tarifa e regjistrimit të pronësisë në bazë të ndërrimit/këmbimit të pronës së paluajtshme

Tarifa për regjistrimin e pronësisë në bazë të ndërrimit-këmbimit të pronës së paluajtshme për secilin pronar..... katërdhjetë (40) €.

Neni 32

Tarifa për regjistrimin e të drejtës së shfrytëzimit-qirambajtja

1. Tarifa për regjistrimin e të drejtës së shfrytëzimit – qirambajtjes për çdo njësi kadastrale, kur pronar është Qeveria apo Komuna, me kohëzgjatje deri në 10 vite.....dhjetë (10) €.

2. Tarifa për regjistrimin e të drejtës së shfrytëzimit – qirambajtjes për çdo njësi kadastrale, kur pronar është Qeveria apo Komuna, me kohëzgjatje prej dhjetë (10) vite deri në katërdhjetë (40) vite.....tridhjetë (30) €.
3. Tarifa për regjistrimin e të drejtës së shfrytëzimit – qirambajtjes për çdo njësi kadastrale, kur pronar është Qeveria apo Komuna, me kohëzgjatje prej katërdhjetë (40) vite deri në nëntëdhjetë e nëntë (99) vite.pesëdhjetë (50) €.
4. Tarifa për regjistrimin e qirasë nga personi fizik apo juridik në kohëzgjatje deri në dhjetë (10) vite për çdo njësi kadastrale..... dhjetë (10) €.
5. Tarifa për regjistrimin e qirasë nga personi fizik apo juridik në kohëzgjatje mbi dhjetë (10) vite për çdo njësi kadastrale....njëzet (20) €.
6. Regjistrimi i të drejtës së shfrytëzimit – qirambajtjes për pronat e privatizuara nga ish-Ndërmarrjet Shoqërore, me kohëzgjatje prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite, bëhet duke zbatuar tarifën e përcaktuar sipas nenit 27 të kësaj rregulloreje.

Neni 33

Tarifat për regjistrimin e hipotekës

1. Tarifat për regjistrimin e hipotekës sipas vlerës së kredisë të përcaktuar me dokumentin e hipotekës janë:
 - 1.1 Deri në tridhjetë mijë (30.000) €..... njëzet (20) €;
 - 1.2 Prej tridhjetë mijë e një (30.001) € deri në pesëdhjetë mijë (50.000) €..... tridhjetë (30) €.
 - 1.3 Prej pesëdhjetë mijë e një (50.001) € deri në njëqind mijë (100.000) €..... gjashtëdhjetë **(60)** €;
 - 1.4 Prej njëqind mijë e një (100.001) € deri në dyqind mijë (200.000) €..... nëntëdhjetë **(90)** €;
 - 1.5 Prej dyqind mijë e një (200.001) € deri në pesëqind mijë (500.000) €.....njëqind e njëzet **(120)** €;
 - 1.6 Prej pesëqind mijë e një (500.001) € deri në një milion (1.000.000) €..... dyqind e katërdhjetë **(240)** €;
 - 1.7 Mbi vlerën e një milioni (1.000.000) € tarifa.....katërqind **(400)** €.
2. Hipoteka e cila regjistrohet në dy apo më shumë ZKK, tarifa përpjesëtohet në mënyrë të barabartë.

Neni 34

Tarifat për modifikimin dhe fshirjen e hipotekës

1. Tarifa për modifikimin e hipotekës së regjistruar..... dhjetë (10) €.
2. Tarifat e përcaktuara sipas nenit 36 të kësaj rregulloreje, zbatohen në rastet e ndryshimit të vlerës së kredisë.
3. Lirohet nga tarifa fshirja e hipotekës nga Regjistri.

Neni 35

Tarifa për regjistrimin, modifikimin dhe fshirjen e servitutit

1. Tarifa për regjistrimin e të drejtës së servitutit për secilën parcelë dominante apo person: tridhjetë (30€).
2. Tarifa për modifikimin e servitutit:..... dhjetë (10€).
3. Tarifa për fshirjen e servitutit nga Regjistri: njëzet (20€).

Neni 36

Tarifa për regjistrimin, modifikimin dhe fshirjen e barrave dhe ngarkesave të tjera

1. Lirohet nga tarifa regjistrimi i barrës.
2. Lirohet nga tarifa regjistrimi i masës së sigurisë (masës së përkohshme) apo modifikimi i saj.
3. Tarifa për regjistrimin e vërejtjes sipas Ligjit për Regjistrimin e të Drejtave të Pronës së Paluajtshme:..... katërdhjetë (40€).
4. Tarifa për regjistrimin e ndalesës nga Përmbaruesi Privat apo Gjykata në procedurë përmbarrimore për çdo akt juridik:tridhjetë (30€).
5. Tarifa për regjistrimin e vërejtjes së mbajtësit në pronën e paluajtshme të të mbajturit në momentin e lidhjes së kontratës mbi mbajtjen e përjetshme:njëzet(20€).
6. Lirohet nga tarifa modifikimi i barrës apo ngarkesës tjetër.
7. Lirohet nga tarifa fshirja e barrës apo ngarkesës tjetër.

Neni 37

Tarifa për korrigjimin e të dhënave kadastrale

1. Tarifa për korrigjimin e të dhënave kadastrale që konstatohet se janë regjistruar gabim si pasojë e lidhjes së dokumentacionit të dorëzuar nga palët: tridhjetë..... (30€) .
2. Lirohet nga tarifa për korrigjimin e të dhënave kadastrale që konstatohet se janë regjistruar si pasojë e gabimit të ZKK apo AKK, si dhe të gjitha gabimet e konstatuara nga sistemet e mëparshme.
3. Lirohet nga tarifa për korrigjimin e numrit identifikues "KCID" në numrin personal të pronarëve. ZKK është e obliguar që të bëjë korrigjimin e numrit identifikues "KCID" sipas detyrës zyrtare.

Neni 38

Tarifa për shërbimet online

1. Tarifa për nxjerrjen e certifikatave online:tre (3€).
2. Obligohen përdoruesit e institucioneve publike dhe përdoruesit privatë, të cilët ofrojnë shërbime publike që të bëjnë shënimin në Regjistrin Kadastral për pronën e paluajtshme që është në procedurë ose është përfunduar. Shënimi në Regjistër bëhet pa pagesë.

Neni 39

Tarifa për regjistrimin e të drejtave të tjera

Tarifa për regjistrimin e të drejtave të cilat nuk janë përfshirë në dispozitat e kësaj rregulloreje:pesëdhjetë (50€).

Neni 40

Pajisja me certifikatë

ZKK apo AKK janë të obliguara që pas çdo ndryshimi në Regjistër të pajisin palën me certifikatë pronësie dhe kopje pa pagesë.

Neni 41

Tarifat për dhënien e informatave nga Sistemi i Informacioneve Kadastrale të Tokave të Kosovës nga ZKK-të

1. Tarifat për dhënien e informatave nga Sistemi i Informacioneve Kadastrale të Tokave të Kosovës nga ZKK-të janë:
 - 1.1 Vërtetim që personi fizik ose juridik nuk posedon prona:..... tri (3€);
 - 1.2 Dhënia e vërtetimeve të ndryshme:..... tri (3€);
 - 1.3 Certifikata e pronësisë (deri në dhjetë faqe shënime të shtypura):katër (4€) (+2€ për parcelë);
 - 1.4 Certifikata e pronësisë (mbi dhjetë faqe shënime të shtypura):njëzet (20€);
 - 1.5 Kopja e planit:katër (4€);
 - 1.6 Kopje në formatin A3 me ortofoto (bardhë e zi):katër (4€);
 - 1.7 Kopje në formatin A3 me ortofoto (me ngjyrë):pesë (5€);
 - 1.8 Historiati për një njësi kadastrale:..... njëzet (20€).

Neni 42

Tarifat për bazën gjeodezike

Tarifat për bazën gjeodezike janë:

- 1.1 Pikat trigonometrike: Koordinatat Y, X, H, me përshkrim:pesë (5€);
- 1.2 Pikat lidhëse: Koordinatat Y, X, H, me përshkrim:katër (4€);
- 1.3 Pikat poligonale: Koordinatat Y, X, H, me përshkrim:tri (3€);
- 1.4 Pikë e nivelimit: Koordinatat Y, X, H, me përshkrim:..... pesë (5€);

- 1.5 Pikat në linjë: Koordinatat Y, X, H:dy (2€);
1.6 Pikat e detajit Y, X:një (1€).

Neni 43

Tarifat për të dhënat në formën digjitale

1. Parcela në format digjital (shpfile, dëg, gml, ili) deri në 1 ha – sipas kërkesës së palës (pronarit, të autorizuarit, gjeodeti i licencuar apo kompanisë gjeodete të licencuar):dhjetë (10 €) për njësi.
2. Parcela në format digjital (shpfile, dëg, gml, ili) mbi 1 ha deri në 2 ha – sipas kërkesës së palës (pronarit, të autorizuarit, gjeodetit të licencuar apo kompanisë gjeodete të licencuar):.....njëzet (20€).
3. Parcela në format digjital (shpfile, dëg, gml, ili) mbi 2.01 ha deri në 5 ha – sipas kërkesës së palës (pronarit, të autorizuarit, gjeodeti i licencuar apo kompanisë gjeodete të licencuar):katërdhjetë (40€).
4. Parcela në format digjital (shpfile, dëg, gml, ili) mbi 5 ha – sipas kërkesës së palës (pronarit, të autorizuarit, gjeodetit të licencuar apo kompanisë gjeodete të licencuar):gjashtëdhjetë (60€).
5. CD – kompakt disku:..... zero euro e pesëdhjetë centë (0.50 €).

Neni 44

Tarifat e shërbimit për ndërrimin e kulturave të parcelave

1. Përgatitja e raportit për ndërrimin e kulturës së një parcele pa matje gjeodezike:..... njëzet (20€).

Neni 45

Qiraja për shfrytëzimin e tokës komunale dhe objekteve afariste dhe banesore

1. Komuna mbledh qiranë për shfrytëzimin e pronës komunale nga personat fizikë dhe juridikë.
2. Vlera e qirasë për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme komunale është vlera e tregut e cila bazohet në:
 - 2.1 Madhësinë e ndërtesës ose tokës së matur për metër katror ose ndonjë matje tjetër e sipërfaqes;
 - 2.2 Vendndodhjen dhe llojin e ndërtesës ose tokës;
 - 2.3 Qëllimin e shfrytëzimit, qoftë për ushtrimin e aktiviteteve afariste, tregtisë, banimit, bujqësisë ose punëve profesionale.
3. Komuna mund të përcaktojë një vlerë të qirasë e cila është më e ulët se e tregut nëse shfrytëzimi i propozuar i pronës komunale në mënyrë të qartë i shërben një qëllimi dhe interesi shoqëror ose publik i cili është përcaktuar si i këtillë sipas një rregulloreje të miratuar nga Kuvendi Komunal.

4. Caktimi i vlerës së tregut duhet të bëhet nga komisioni profesional varësisht nga objekti apo prona tjetër. Dhënia me qira e këtyre objekteve dhe paluajtshmërive bëhet vetëm pasi të përfillen të gjitha procedurat sipas legjislacionit në fuqi.
5. Qiratë nga objektet afariste dhe banesore si dhe tokës:
- 5.1 Për lokalet afariste të zonës së parë, qiraja mujore për m² si tarifë fillestare të jetë:..... 5.00 € / m²;
- 5.2 Ndërsa për objektet e banimit po në të njëjtën zonë qiraja mujore të jetë:1.00 € / m²;
- 5.3 Për lokalet afariste të zonës së dytë qiraja mujore për m² të jetë..... 3.00 € / m²;
- 5.4 Ndërsa për objektet e banimit po në të njëjtën zonë qiraja mujore të jetë:1.00 € / m²;
- 5.5 Për lokalet afariste të zonës së tretë qiraja mujore për m² të jetë:.....1.50 € / m².
- 5.6 Ndërsa për objektet e banimit po në të njëjtën zonë, qiraja mujore të jetë:1.00 € / m²;
- 5.7 Qiraja e tokës, zona e I (parë) dhe e II (dytë), vjetore për m² të jetë:1.00 € / m²;
- 5.8 Qiraja e tokës, zona e III (tretë) dhe e IV (katërt), vjetore për m² të jetë:..... 0.80 € / m²;
- 5.9 Qiraja e tokës, zona e V (pestë) e deri te e VIII (tetë), vjetore për m² të jetë:..... 0.60 € / m²;
- 5.10 Qiraja për regjistrimin e kabllave nëntokësore:0.20 € / m².
6. Qiraja vjetore nga dhënia e tokës bujqësore në shfrytëzim sipas klasave:
- 6.1 Klasa I (parë) dhe II (dytë):100 € / ha;
- 6.2 Klasa III (tretë) dhe IV (katërt):80 € / ha;
- 6.3 Klasa V (pestë) deri në të VIII (tetë):60 € / ha.
7. Të dhënat për caktimin e zonës së cilës i takon objekti afarist, banesor dhe toka bujqësore, merren nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër.

KAPITULLI XI

Neni 46

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI, SPORT

1. Tarifat e përgjithshme në kulturë, rini dhe sport:

Nr.	EMËRTIMI (i tarifës dhe taksave në shërbime)	Vendi	Euro
1.1	Për çdo manifestim fitimprurës për palën e kontraktuar në shtëpinë e kulturës dhe objektet kulturore për 1 (një) orë	Shtëpia e kulturës	50.00 €
1.4	Anëtarësia vjetore për leximin e librave	Biblioteka	0.00 €

1.5	Shfrytëzimi i terreneve sportive nga klubet sportive jashtë komunës për zhvillimin e ndeshjeve zyrtare	Palestra sportive	150.00 €
1.6	Shfrytëzimi i terreneve sportive nga klubet sportive jashtë komunës për stërvitje për 1 (një) orë	Palestra sportive	20.00 €
1.7	Shfrytëzimi i terreneve sportive nga klubet sportive private për zhvillimin e ndeshjeve sportive për 1 (një) orë	Palestra sportive	25.00 €

Nr.	EMËRTIMI (i tarifës dhe taksave në shërbime)	Vendi	Euro
1.9	Për ngjarje komerciale fitimprurëse për palën, fushata politike, për 1 (një) orë	Hapësirat publike	20.00 €
1.10	Për bizneset fitimprurëse që merren me veprimtari kulturore dhe artistike të jashtme për 1 (një) orë	Hapësirat publike	50.00 €
1.11	Shfrytëzimi i terreneve rekreative-sportive dhe hapësirave kulturore nga klubet sportive dhe grupet rinore, shoqëritë kulturore të Komunës sonë	Hapësirat publike	Falas

Neni 47

Dispozitat e veçanta (dispozitat lehtësuese – lirimi nga taksat)

1. Tubimet përkujtimore.
2. Tubimet e organizuara nga KK.
3. Të gjitha aktivitetet e organizuara nga DKRS.
4. Të gjitha aktivitetet e organizuara nga institucioni parashkollor, shkollat fillore dhe shkollat e mesme publike.
5. Shoqatat për persona me aftësi të kufizuara.
6. Shoqatat e dala nga lufta, familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës.
7. Bashkësitë fetare.

8. Ngjarjet kulturore dhe artistike jofitimprurëse.
9. Zhvillimi i ndeshjeve sportive ku nikoqirë janë ekipet vendase.

KAPITULLI XII

Neni 48

DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE DHE DREJTORIA PËR EMERGJENCË

1. Tarifa (taksa) në shërbimet publike, siguri dhe emergjencë:

Nr. R	EMËRTIMI (i tarifës dhe taksave në shërbime)	Euro
1.1	Inspektimi me kërkesë të palës jashtë qytetit	0.00 €
1.2	Inspektimi me kërkesë të palës në qytet	0.00 €
1.3	Lëshimi i vërtetimeve, certifikatave dhe dokumenteve të tjera	0.00 €
1.4	Dhënia e pëlqimit për pompa të benzinës, pishina etj.	15.00€
1.5	Shfrytëzimi i hapësirave publike rreth vend punishteve	1.00€/m ²

KAPITULLI XIII

GJOBAT KOMUNALE PËR LËSHIMIN E CERTIFIKATAVE DHE DOKUMENTEVE ZYRTARE

Neni 49

Gjobat lidhur me mosparaqitjen e lindjes dhe vdekjes

1. Çdo person fizik përgjegjës i cili nuk paraqet lindjen e fëmijës në territorin e Komunës në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga data e lindjes, kryen kundërvajtje të lehtë dhe nga Komuna i shqiptohet gjobë në vlerë:njëzet euro (20 €).
2. Çdo person fizik përgjegjës i cili nuk e lajmëron vdekjen e personit të regjistruar me vendbanim në Komunë brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e vdekjes së personit brenda Republikës së Kosovës, apo brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve për vdekjet e ndodhura jashtë Republikës së Kosovës, kryen kundërvajtje të lehtë dhe nga Komuna i shqiptohet gjobë në vlerë:..... pesëdhjetë euro (50 €).
3. Çdo drejtues i spitalit, burgut, institucionit të riedukimit dhe institucioneve të tjera përkatëse i cili nuk e lajmëron vdekjen e personit të regjistruar me vendbanim në Komunë brenda pesë (5)

ditëve nga data e vdekjes së ndodhur në institucionet e tyre, kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë:..... njëqind euro (100 €), ndërsa pesëdhjetë (50 €) do të dënohet zyrtari kompetent.

Neni 50

Gjobat lidhur me vendbanimin dhe vendqëndrimin

1. Me gjobë prej pesëdhjetë euro (50 €) do të dënohet për kundërvajtje qytetari që nuk e lajmëron ndryshimin në afatin prej 8 (tetë) ditësh nga dita e vendosjes tek organi kompetent i vendbanimit të ri:
 - 1.1 Nuk e lajmëron vendbanimin dhe ndryshimin e adresës së banimit apo nuk çlajmëron vendbanimin e përhershëm;

KAPITULLI XIV

GJOBAT KOMUNALE PËR SHËRBIMET PUBLIKE

Neni 51

Gjobat për mos-pagesën e taksës komunale për Linjat Urbane dhe Autotaksi

1. Operatori i transportit të udhëtarëve (për automjetet 8+1 ulëse e më shumë) që operon pa licencë, leje apo rend të udhëtimit dënohet me gjobë prej një mijë (1,000.00 €) euro, ndërsa personi fizik dhe personi përgjegjës i personit juridik dënohet me gjobë prej:..... njëqind (100.00 €).
Skadimi i lejes së operimit për autotaksi më tepër se tridhjetë ditë, dënohet me gjobë prej:njëzet (20.00 €).

Neni 52

Gjobat për mos-pagesën e taksës komunale për ndërhyrje në infrastrukturë komunale – grupimi i sipërfaqeve publike

Çdo person i cili nuk e paguan taksën komunale për ndërhyrje në infrastrukturë komunale pa leje të organit kompetent komunal, kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë si në vijim:

- 1.1 Për personin fizik:..... dyqind euro (200 €);
- 1.2 Për personin fizik që ushtron biznes individual: pesëqind euro (500 €);
- 1.3 Për personin juridik:..... pesë mijë euro (5000 €).

Neni 53

Gjobat lidhur me taksat komunale për vendosjen e objekteve në hapësirat publike

1. Çdo person i cili nuk e paguan taksën komunale për vendosjen e objekteve të ndryshme në hapësirën publike sipas dispozitave të kësaj rregulloreje, e cila kalon vlerën mbi njëqind euro (100 €), kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë si në vijim:
 - 1.1 Individët dhe shoqëritë tregtare të regjistruara si biznes

individual:..... njëqind euro (100€) dhe;
1.2 Shoqëritë tregtare të tjera:..... dyqind euro (200 €).

Neni 54

Gjohat lidhur me mos-pagesën e taksës komunale për vendosjen e panove reklamuese

1. Çdo shoqëri tregtare i cili nuk paguan taksë komunale mbi vendosjen e panove reklamuese në hapësirën publike gjobitet:njëqind euro (100 €).

Neni 55

Gjohat për mos-pagesën e taksës komunale për bllokimin e rrugëve lokale

1. Çdo person i cili nuk e paguan taksën komunale për bllokimin e rrugëve lokale sipas dispozitave të kësaj rregulloreje, kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë si në vijim:
 - 1.1 Personat fizikë dhe shoqëritë tregtare të regjistruara si biznes individual:
..... dyqind euro (200 €);
 - 1.2 Personat juridikë:..... treqind euro (300 €).

Neni 56

Gjoha për ushtrimin e veprimtarisë afariste pa pëlqim për plotësimin e kushteve

1. Çdo subjekt afarist që ushtron veprimtarinë afariste pa pëlqim nga inspektorati i tregut për pranimin e kushteve teknike për ushtrimin e veprimtarisë, gjobitet me gjobë dhe atë:
 - 1.1 Personat juridikë:..... një mijë euro(1000 €);
 - 1.2 Personi përgjegjës i personit juridik:..... treqind euro(300 €);
 - 1.3 Personat fizikë:dyqind euro (200 €).

Neni 57

Pagesat e gjobave dhe çështjet tjera mandatore

1. Gjohat të përcaktuara me këtë rregullore paguhen brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga datat e shqiptimit të tyre.
2. Në rast të pagimit të gjobës së shqiptuar me këtë rregullore brenda afatit prej tetë (8) ditësh, pagesa bëhet pesëdhjetë për qind (50%) të shumës së gjobës së shqiptuar.
3. Shqiptimi i sanksioneve kundërvajtëse me gjobë dhe e drejta në mjete juridike të personave ndaj të cilëve shqiptohet gjobë bëhet në përputhje me legjislacionin përkatës për kundërvajtjet dhe legjislacionin përkatës për procedurën e përgjithshme administrative.
4. Procedurat kundërvajtëse zhvillohen nga Komuna në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 58

Taksa Qendrore

1. Me qëllim të zbatimit të legjislacionit në fuqi të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, Komuna ofron shërbime të ndryshme të deleguara nga niveli qendror dhe mbledh taksë të përcaktuar nga ky nivel, si në vijim:
2. Taksa sipas Udhëzimit Administrativ (MMPH) Nr. 12/19, i datës 15.11.2019 Për Ndarjen dhe Regjistrimin e Parcelës, Udhëzimit Administrativ (MEA) Nr. 09/2020 i datës 12.11.2020 Për Tarifat e Shërbimeve Për Regjistrimin e të Drejtave të Pronës së Paluajtshme si dhe me Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr. 05/2021 i datës 08.12.2021 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MEA) Nr. 09/2020 Për Tarifat e Shërbimeve Për Regjistrimin e të Drejtave të Pronës së Paluajtshme;
3. Taksa sipas Udhëzimit Administrativ nr. 02/2018 më 05.06.2018 (MMPH), mbi taksat administrative për lëshimin e lejes së ndërtimit dhe tarifat për rregullimin e infrastrukturës / Udhëzimit Administrativ (MMPHI) për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ nr. 02/2018, mbi taksat administrative për lëshimin e lejes së ndërtimit dhe tarifat për rregullimin e infrastrukturës, Nr. 05/2022 më 16.06.2022. Ligjit Nr. 06/L-024 Për Trajtimin e ndërtimeve pa leje (Vendimi i Ministrit të MMPHI Nr. 3393/21 datë 27.08.2021).
4. Taksa për dhënien e lejes mjedisore të përcaktuara sipas Udhëzimit Administrativ MMPH - Nr. 01/2017 për Dhënien e Lejes Komunale Mjedisore, apo çdo legjislacioni pasues;
5. Taksa për shërbimet shëndetësore të përcaktuara sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2007 – Mbledhja dhe Shfrytëzimi i Mjeteve nga Bashkë-Pagesat e Shfrytëzuesve të Shërbimeve Shëndetësore dhe të Hyrave Vetanake të Institucioneve Shëndetësore apo çdo legjislacioni pasues;
6. Taksa për vijim dhe përfundim të arsimit dhe aftësimin për të rritur të përcaktuara sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 11/2011 për Participim të Vijuesve të Arsimit dhe Aftësimin për të Rritur, apo çdo legjislacioni pasues;
7. Taksa për lëshimin e dokumentacionit arsimor duplikat, të përcaktuara sipas Udhëzimit Administrativ 03/2013 – Lëshimi i Dokumenteve Duplikatë nga Institucionet Edukativo-Arsimore dhe Universitare, apo çdo legjislacioni pasues;
8. Çdo akt normativ tjetër i Qeverisë së Republikës së Kosovës apo ndonjë agjencie të pavarur që miratohet pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje që parasheh taksa qendrore, zbatohet nga Komuna, pa pasur nevojë që kjo rregullore të ndryshojë.
9. Udhëzim administrativ nr. 06/2010 për mënyrën dhe procedurat e shitjes së trungjeve pyjore dhe asortimenteve drusore nga pyjet publike.

Neni 59

Transparenca në taksat komunale

10. Kuvendi Komunal përditëson taksat dhe gjobat e kësaj rregulloreje me një vendim dhe të publikojë ato, kurdo që Qeveria e Republikës së Kosovës apo ndonjë agjenci e pavarur ndryshon taksat ekzistuese qendrore apo përcakton ndonjë taksë tjetër.

KAPITULLI XV

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 60

Epërsia me ligjet dhe aktet tjera nënligjore

Në raste konflikti dhe mospërputhje të dispozitave të kësaj rregulloreje dhe në të gjitha rastet që nuk janë të rregulluara me këtë rregullore, do të zbatohen dispozitat e ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi e të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Neni 61

Zbatimi

Për zbatimin e kësaj rregulloreje do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe drejtorët e drejtorive të Komunës së FushënKosovës.

Neni 62

Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja Nr. 63 e datës 16/05/2013, për tarifa, ngarkesa dhe gjobat nga shërbimet dhe veprimtaritë komunale.

Neni 63

Hyrja në fuqi

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Fushë-Kosovë, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008" dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores (QRK) Nr. 03/2026, për procedurën e shqyrtimit administrativ të akteve të komunave të datës 20.02.2026 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen zyrtare të Komunës.

Neni 64

Implementimi

Kjo rregullore fillon të zbatohet-implementohet nga data e vendosur nga Kuvendi i Komunës me datë 01.07.2026.

KUVENDI I KOMUNËS SË FUSHË-KOSOVËS
01-Nr- _____, më _____.

KRYESUESI I KUVENDIT
Vlonjat Hasani
